

Regjistrimi i një biznesi. Si të realizojmë konkretisht një ide biznesi.

Projekti: Parandalimi dhe Riintegrimi i Sigurt: Qasje Holistike dhe
Qëndrueshmëri ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm

Av. Erli ZDRAVA

Trajnues



SI TË KRIJOJMË NJË BIZNES

- Cilat janë idetë e biznesit që duam të materializojmë.
- Idetë e materializuara në një plan biznesi duhet të realizohen konkretisht.
- Roli rregullator i institucioneve publike në regjistrimin, funksionimin dhe mbylljen e një biznesi.
- Mbështetja e institucioneve publike për sipërmarrjet e reja.
- Biznesi i regjistruar si gjenerues të ardhurash dhe taksimi i bizneseve.
- Shërbimet e nevojshme që duhet të ofrojë administrata publike vendore dhe qendrore ndaj biznesit.

ÇFARË JANË STARTUP-ET

- “*Startup*” janë individët dhe personat fizikë ose juridikë
- të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët, referuar objektit të aktivitetit të tyre, janë konceptuar, krijuar dhe veprojnë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një *modeli biznesi*,
- ***produkti dhe shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik i veçantë,***
- me *potencial rritjeje të shpejtë,*
- të *zbatueshëm në praktikë,*
- për *përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese.*

FUSHAT PRIORITARE TË SIPËRMARRJEVE STARTUP

- Grantet dhe fondet për mbështetjen e sipërmarrjeve startup kanë në fokus veçanërisht fusha si:
 - a) mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;
 - b) mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;
 - c) *fuqizimi i të rinjve;*
 - ç) *fuqizimi i vajzave dhe grave* sipërmarrëse;
 - d) fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;
 - dh) prioritete të tjera, sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

OBJEKTIVAT E MBËSHTETJES SË STARTUP-EVE

- Mbështetja për zhvillimin e startup-eve ka për synim:
 - a) lehtësimin e *krijimit, hyrjes në treg* dhe ushtrimin e veprimtarisë së startup-eve;
 - b) krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e *talentit dhe burimeve njerëzore*;
 - c) lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare;
 - ç) përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të *vlerave demokratike*.

FORMAT E MBËSHTETJES SË STARTUP-EVE

- Mbështetja për zhvillimin e startup-eve kryhet nëpërmjet:
 - a) shërbimit “startup one-stop-shop” për mbështetjen e startup-eve;
 - b) zhvillimit të *ekosistemit mbështetës* për startup-et;
 - c) *dhënies së granteve financiare* ose masave mbështetëse për zhvillimin e startup-eve;
 - ç) *formave të tjera* mbështetëse e lehtësuese të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta

TREGTARI

- Tregtari është personi fizik, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm.
- Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status.
- Personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agrobiznes).

SHOQËRITË TREGTARE (LLOJET)

- Shoqëria Kolektive;
 - Shoqëria Komandite;
 - Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar;
 - Shoqëria aksionere;
-
- Si të zgjedhim formën e përshtatshme për biznesin tonë.

REGJISTRIMI I BIZNESIT NË QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT

- Për regjistrimin fillestar të **tregarit** (personave fizikë) janë të detyrueshme këto të dhëna:
 - a) të dhënat e identifikimit;
 - b) vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
 - c) fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
 - ç) specimeni i nënshkrimit (firmës) të personit fizik.

REGJISTRIMI I BIZNESIT NË QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT

- Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme këto të dhëna:
- a) emri;
- b) forma;
- c) data e themelimit;
- ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- d) selia;
- dh) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
- e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- ë) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.
- f) specimentet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

BIZNESI I VOGËL DHE TATIMET E LEHTESIRAT FISKALE

- Tatimi i biznesit të vogël;
- Taksat dhe tarifat vendore;

- Lehtësirat fiskale për sektorë të veçantë:
 - Agrobiznesi;
 - Turizmi.

FALEMINDERIT